

Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

Raportimi Financiar
Financial Reporting

P5

Zgjidhjet

Data 18/01/2020

1.

a) **Shpjego trajtimin në kontabilitet për ‘konsideratën e shtyrë’ dhe ‘konsideratën kontigjente’ në kontekst të blerjes së një filiali (dege) nga një entitet mëmë. (4 pikë)**

b) Ju jeni një kontabilist financiar i Jupiter sh.a (Jupiter), një kompanie e cila merret me shitjen me pakicë të produkteve ushqimore. Gjatë vitit 2019, Jupiter bleu aksione të ekuitetit në Latona sh.a (Latona) dhe Apollo sh.a (Apollo). Pasqyrat e të ardhurave të Jupiter, Latona dhe Apollo për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019 janë si në vijim:

Pasqyra e të ardhurave për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019

	Jupiter	Latona	Apollo
	€'milion	€'milion	€'milion
Të hyrat	450	150	75
Kosto e shitjes	<u>(300)</u>	<u>(90)</u>	<u>(45)</u>
Fitimi bruto	150	60	30
Shpenzimet operaive	<u>(25)</u>	<u>(15)</u>	<u>(5)</u>
Fitimi operativ	125	45	25
Interesi dhe ngarkesa të ngjajshme	<u>(15)</u>	<u>(5)</u>	<u>(1)</u>
Fitimi para tatimit	110	40	24
Tatimi	<u>(27.5)</u>	<u>(10)</u>	<u>(6)</u>
Fitimi për vitin	82.5	30	18
Fitimet e mbajtura në fillim të vitit	117.5	45	7
Fitimet e mbajtura në fund të vitit	200	75	25

Informata shtesë:

- i) Aksionet e zakonshme dhe fitimet e mbajtura janë të vetmit përbërës të ekuitetit në të tri kompanitë.
- ii) Me 1 prill 2019, Jupiter bleu 12 milion prej 15 milion aksioneve të zakonshme €1 në Latona me një kosto prej €8 për aksion të zakonshëm. Në datën e blerjes vlerat e drejta të pasurive neto të Latonës ishin të barabarta me vlerat e tyre në libra me përjashtim të pronës, detajet e të cilës janë si në vijim:

	€'milion
Kosto	75
Zhvlerësimi i akumuluar me 1 janar 2019	<u>(6)</u>
Neto vlera në libra me 1 janar 2019	69

Prona e cila kishte jetë ekonomike të përdorimit prej 25 viteve me 1 janar 2017, është në një lokacion shumë të mirë komercial dhe vlera i është rritur në mënyrë dramatike që nga koha kur ishte blerë nga Latona me 1 janar 2017. Kosto e zëvendësimit të një ndërtese të

ngjajshme, me jetë të ngjajshme ekonomike të përdorimit me 1 prill 2019, ishte €100 milion. Vlera e drejtë në blerje nuk është reflektuar në shënimet e Latonës.

- iii) Me 1 korrik 2019, Jupiter bleu 4 milion prej 10 milion aksioneve të zakonshme €1 në Apollo me një kosto prej €6 për aksion të zakonshëm. Në datën e blerjes vlerat e drejta të pasurive neto të Apollos ishin të barabarta me vlerat e tyre në libra me përjashtim në pronës e cila kishte vlerë të drejtë prej €9 milion mbi vlerën e saj në libra dhe një jetë të mbetur ekonomike të përdorimit prej katër viteve.
- iv) Në gusht 2019, Jupiter shiti mallra tek Latona për €7.5 milion dhe 20% e këtyre mallrave mbetën pa u shitur me 31 dhjetor 2019. Jupiter i vendos çmimet e saj të shitjes me kosto plus 50%.
- v) Me 13 janar 2020, Jupiter e shiti ndërtesën e zyreve qendrore administrative për €1.25 milion. Me 31 dhjetor 2019, ndërtesa ishte në shitje dhe e lirë pasi që stafi tashmë ishte zhvendosur tek ndërtesa e re. Vlera në libra e ndërtesës në pasqyrën e pozitës financiare të Jupiter me 31 dhjetor 2019 ishte €2 milion.
- vi) Secila kompani ngarkon zhvlerësimin tek shpenzimet operative në bazë të pjesës kohore me metodën drejtvizore.
- vii) Drejtorët e Jupiter besojnë se çfardo zëri i mirë i krijuar në blerjen e Latonës dhe Apollos është dëmtuar për 25% me 31 dhjetor 2019. Drejtorët kanë një politikë të matjes së interesave jo-kontrollues sipas pjesës proporcionale të neto pasurive të identifikueshme.
- viii) Aksionet e zakonshme dhe fitimet e mbajtura janë të vetmit përbërës të ekuitetit në të tri kompanitë.

(Shënim: Të gjitha llogaritjet mund të rrumbullakësohen në €0.01 milion dhe supozoni që të gjitha shpenzimet dhe përfitimet ndodhin njëtrajtësisht përgjatë vitit përveç nëse ju janë dhënë instruksione tjera.)

Kërkohet:

Përgatiteni pasqyrën e konsoliduar të të ardhurave për grupin Jupiter për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019 në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

(16 pikë)

(Total: 20 pikë)

Zgjidhja e problemit 1

a)

Trajtimi në kontabilitet për konsideratën e shtyrë:

- Konsiderata e shtyrë duhet të njihet nga blerësi në datën e blerjes sipas vlerës së drejtë të saj.
- Kjo zakonisht njihet si pjesë e kostos së investimit dhe si një detyrim në pasqyrën e konsoliduar të pozitës financiare.
- Kjo zakonisht është shuma e në para për të cilën është arritur marrëveshja, e skontuar në datën e blerjes sipas kostos së kapitalit të blerësit.
- Skontimi zvogëlohet përgjatë kohës nga blerësi duke e njohur atë si kosto të financimit me kalimin e kohës në periudhën pas blerjes.
- Detyrimi në secilën datë të raportimit do të jetë vlera e drejtë e saj në fillim plus shuma e skontimit që është zvogëluar deri në këtë datë.

Trajtimi në kontabilitet për konsideratën kontigjente:

- Çdo konsideratë kontigjente duhet gjithashtu të njihet sipas vlerës së saj të drejtë. Kjo natyrisht do të përfshijë një zbritje për të reflektuar kohën e shtyrë të pagesës plus një zbritje për të reflektuar probabilitetin që shuma do të paguhet pjesërisht apo të mos paguhet fare.
- Zëri i mirë llogaritet duke u bazuar në këtë vlerësim. Në secilën datë të raportimit pas blerjes, vlera e drejtë ri-vlerësohet, dhe çdo ndryshim raportohet ne fitim ose humbje (të blerësit) në vitin e ri-vlerësimit.
- Çdo ndryshim si shkak i zvogëlimit të skontimit të vlerës në kohë të parasë njihet si kosto e financimit.
- Shuma e ri-vlerësuar mbetet si detyrim deri në ri-vlerësimin tjetër, apo deri sa të paguhet.

b)

Grupi Jupiter

Pasqyra e konsoliduar e të ardhurave për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019

	€' milion
Të hyrat $(450 + (150 \times 9/12) - 7.5 (L14))$	555
Kosto e shitjes $(300 + (90 \times 9/12) - 7.5 (L14) + 0.5(L14))$	<u>(360.5)</u>
Fitimi bruto	(194.5)
Shpenzimet operative $(25 + (15 \times 9/12) + 4.15(L11) + 1.05(L13) + 0.75 (L17))$	<u>(42.2)</u>
Fitimi operativ	152.3
Interesi dhe ngarkesa të ngjajshme $(15 + 5 \times (9/12))$	(18.75)
Pjesa e fitimit të shoqëris (Apollo) L16	<u>3.15</u>
Fitimi para tatimit	136.7
Tatimi $(27.5 + 10 \times 9/12)$	<u>(35)</u>
Fitimi për vitin	101.7
Interesi jo-kontrollues (L15)	<u>(4.29)</u>
	97.41
Fitimet e mbajtura në fillim të vitit	117.5
Fitimet e mbajtura në fund të vitit	212.41

1) Zëri i mirë		
	€'million	€'million
Investimet sipas kostos	96	
Interesi jo-kontrollues (20% x 99.25)	<u>19.85</u>	
		115.85
Neto pasuritë e blera		
€1 aksione të zakonshme	15	
Fitimet para blerjes (1 janar 2019)	45	
Fitimet para blerjes në vitin 2019 (€30 milion x 3/12)	7.5	
Korigjimet e vlerës së drejtë (L12)	<u>31.75</u>	
		<u>99.25</u>
		16.60
Dëmtimi @ (25% x 16.60)		<u>4.15</u>
		12.45
Qasje alternative		
Zëri i mirë		
	€'million	€'million
Investimet sipas kostos		96
Neto pasuritë e blera		
€1 aksione të zakonshme	15	
Fitimet para blerjes (1 janar 2019)	45	
Fitimet para blerjes në vitin 2019 (€30 milion x 3/12)	7.5	
Korigjimet e vlerës së drejtë (L12)	<u>31.75</u>	
	99.25	
Pjesa e grupit (80% x 99.25)		<u>79.40</u>
		16.60
Dëmtimi @ (25% x 16.60)		<u>4.15</u>
		12.45
2) Korigjimet e vlerës së drejtë	€'million	€'million
Kosto e zëvendësimit me 1 prill 2019		100
Vlera neto në libra me 1 janar 2019	69	
Zhvlerësimi 1 janar 2019 deri me 1 prill 2019: (€75 milion/25) x 3/12	<u>(0.75)</u>	<u>68.25</u>
		31.75
3) Zhvlerësimi shtesë në korigjimet e vlerës së drejtë (€31.75 milion/22.75 vite të mbetura) x 9/12		€'million 1.05
4) Transaksionet ndërmjet kompanive Elimino shitjet ndërmjet kompanive dhe koston e shitjeve:		€7.5 milion
Elimino FPR në stoqe (€7.5 milion/5) x 50/150		€0.5 milion
5) Interesi jo-kontrollues		€'million
Neto fitimi për vitin (9/12 x 30m)		22.5
Minus zhvlerësimi në korigjimin e vlerës së drejtë		<u>1.05</u> 21.45
		x 20% = 4.29
6) Pjesa e fitimit të shoqërisë		€ million
Fitimi për vitin (€18 milion x 6/12 x 0.4)		3.6
Korigjimi i zhvlerësimit (€9 milion/4 x 0.4 x 6/12)		<u>(0.45)</u>

7) shitja e ndërtesës së vjetër të zyreve qendrore

SNK 10 *Ngjarjet pas periudhës raportuese* thotë që shitjet e pasurive jo-qarkulluese janë ngjarje jo-korigjuese dhe pasqyrat zakonisht nuk do të ndryshohen për të reflektuar këtë (edhe pse do të shpaloset në shënime). Megjithatë, në këtë rast, mund të argumentohet se çmimi i shitjes është evidencë e dëmtimit në fund të vitit përveç nëse mund të argumentohet se kushtet të cilat kanë shkaktuar dëmtimin kanë ndodhur pas përfundimit të vitit atëherë pasqyrat financiare do të ndryshoheshin. Duke qenë se shitja ka ndodhur me 13 janar 2020, ka shumë mundësi që kushtet kanë ekzistuar në atë datë në pasqyrën e pozitës financiare. Andaj dëmtimi duhet të ngarkohet në pasqyrat financiare të vitit 2019 në pasjtim me SNK 36 *Dëmtimi i pasurive*.

D Pasqyra e të ardhurave – shpenzimet operative	€0.75 milion	
K Prona		€0.75 milion

Prona do të klasifikohet si 'pasuri jo-qarkulluese e mbajtur për shitje në pajtim me SNRF 5 *Pasuritë jo-qarkulluese të mbajtura për shitje dhe operacionet e ndërprera*.

2. Bilanci vërtetues në vijim është i Vesta sh.a me 31 dhjetor 2019	<u>Debi</u>	<u>Kredi</u>
	€'000	€'000
Të hyrat		930,000
Stoqet me 31 dhjetor 2019	84,600	
Kosto e shitjeve	703,500	
Kosto e shpërndarjes	58,500	
Shpenzimet administrative	82,500	
Dividenda e përkohshme e paguar	24,000	
Aksionet e ekuitetit prej €0.50 secila		120,000
Fitimet e mbajtura me 31 dhjetor 2018		132,300
Tatimi aktual	2,100	
Tatimi i shtyrë		25,200
Prona sipas vlerësimit me 31 dhjetor 2018 (shënim (ii))	75,600	
Fabrika dhe paisjet sipas kostos (shënim (ii))	140,400	
Fabrika me lizing sipas kostos (shënim (ii))	60,000	
Zhvlerësimi i akumuluar 31 dhjetor 2018		
Fabrika dhe paisjet		38,400
Fabrika me lizing		15,000
Pagesat e lizingut me 31 dhjetor 2019 (shënim (ii))	18,000	
Detyrimi ndaj lizingut me 1 janar 2019 (shënim (ii))		46,800
Kosto e kontratës (shënim (i))	60,000	
Të arkëtueshmet tregtare	99,300	
Banka	16,500	
Të pagueshmet tregtare		100,200
Pagesat nga klientët për ndërtimin e urës		17,100
	<u>1,425,000</u>	<u>1,425,000</u>

Informatat në vijim janë të rëndësishme:

- (i) Vesta sh.a hyri në një kontratë ndërtimi me 1 korrik 2019 për të ndërtuar një urë. Çmimi i kontratës është €150 milion dhe ndërtimi pritet të përfundoj me 30 qershor 2021.

Kostot e kontratës në bilancin vërtetues përfshijnë €36 milion për materialet, punën dhe shpenzimet e përgjithshme dhe €24 milion për një fabrike të specializuar të blerë me 1 korrik 2019.

Me 31 dhjetor 2019, vlera e punës e certifikuar sipas çmimit të shitjes u dakordua në €66 milion dhe nuk është njozur ende si e hyrë. Kostoja e mbetur e kontratës deri në përfundimin është vlerësuar të jetë €30 milion. Kjo shume prej €30 milion nuk përfshin zhvlerësimin e fabrikës së specializuar. Fabrika e specializuar nuk do të ketë vlerë të mbetur në fund të kontratës dhe do të zhvlerësohet në baza drejtvizore sipas proporcionit kohor.

Vesta sh.a njih të hyrat nga kontrata e ndërtimit duke u bazuar në vlerën e punës së certifikuar sipas çmimit të shitjes si përqindje e çmimit total të kontratës.

- (ii) Me 1 janar 2018, Vesta sh.a bleu një pronë (ndërtesë pa tokë) për €90 milion e cila kishte jetëgjatësi prej 15 vite. Politika e kontabilitetit është të rivlerësohet prona sipas vlerës së drejtë çdo fundvit. Vlerësimi në bilancin vërtetues prej €75.6 million i datës 31 dhjetor 2018 krijoi një humbje prej €8.4 milion e cila ishte raportuar në pasyrën e të ardhurave në vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2018. Me 31 dhjetor 2019 prona është rivlerësuar në €74.7 milion. Prona zhvlerësohet duke përdorur metodën drejtvizore dhe nuk ka vlerë të mbetur.

Fabrika dhe paisjet zhvlerësohen me 25% në vit duke përdorur metodën e saldo së zbritur.

Fabrika e marrë me lizing është lizing financiar dhe është marrë me 1 janar 2018. Pagesat e lizingut janë €18 milion në vit për katër vite të paguara në fund të çdo viti me 31 dhjetor.

Nuk ka normë të nënkuptuar për lizingun por Vesta sh.a ka një kosto të huamarrjes prej 8% në vit. Kjo fabrikë zhvlerësohet përgjatë kohëzgjatjes së lizingut.

Asnjë zhvlerësim nuk është ngarkuar për pasuritë jo-qarkulluese për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019. I gjithë zhvlerësimi ngarkohet tek kosto e shitjeve.

- (iii) Drejtorët e Vesta sh.a kanë vlerësuar provizionet për tatimin në fitim për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019 në €13.5 milion. Provizionet e kërkuara për tatimin e shtyrë me 31 dhjetor 2019 janë €16.8 milion. Të gjitha korigjimet e tatimit të shtyrë duhet të dërgohen tek pasqyra e të ardhurave. Saldo e tatimit aktual në bilancin vërtetues paraqet nën-provizionimin/mbi-provizionimin e detyrimit ndaj tatimit për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2018.
- (iv) Drejtorët e Vesta sh.a deklaruan dividendë tjetër prej €0.4 milion me 15 dhjetor 2019 përveç atyre të paguara gjatë vitit të përfunduar me 31 dhjetor 2019. Kjo shumë është e pagueshme.

Kërkohet:

(a) **Përgatiteni pasqyrën e të ardhurave për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019. (13 pikë)**

(b) **Përgatiteni pasqyrën e pozitës financiare me 31 dhjetor 2019.**

(7 pikë)

(Total: 20 pikë)

Zgjidhja e problemit 2

a) Pasqyra e të ardhurave të Vesta sh.a për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019

	€'000
Të hyrat (930,000 + 66,000 L13)	996,000
Kosto e shitjes (L12)	<u>(789,000)</u>
Fitimi bruto	207,000
Shpenzimet administrative	(82,500)
Përfitim nga rivlerësimi	4,500
Kosto e shperndarjes	<u>(58,500)</u>
Fitimi operativ	70,500
Kosto e financimit (L15)	<u>(3,744)</u>
Fitimi para tatimit	66,756
Tatimi në fitim (L17)	<u>(7,200)</u>
Fitimi për vitin	59,556

b) Pasqyra e pozitës financiare të Vesta sh.a-së me 31 dhjetor 2019

	€'000
<i>Pasuritë qarkulluese</i>	
Prona, Fabrika dhe paisjet (L11 & L14)	199,200
<i>Pasuritë qarkulluese</i>	
Stoqet	84,600
Të arkëtueshmet tregtare	99,300
Pasuritë e kontratës (L13)	51,300
Banka	<u>16,500</u>
<i>Total pasuritë qarkulluese</i>	<u>251,700</u>
Total pasuritë	450,900
<i>Ekuiteti dhe detyrimet</i>	
Aksionet e ekuitetit prej €0.50 secila	120,000
Fitimet e mbajtura (L16)	<u>167,456</u>
<i>Total ekuiteti</i>	287,456
<i>Detyrimet afatgjata</i>	
Tatimi i shtyrë	16,800
Detyrimi ndaj lizingut	<u>17,148</u>
<i>Total detyrimet afatgjata</i>	33,948
<i>Detyrimet afatshkurtëra</i>	
Të pagueshmet	100,200
Detyrimi ndaj lizingut	15,396
Tatimi aktual i pagueshem	13,500
Dividenda e pagueshme	<u>400</u>
<i>Total detyrimet afatshkurtëra</i>	<u>129,496</u>
Total ekuiteti dhe detyrimet	450,900

Llogaritjet

1. PFP

	Prona €'000	Fabrika & paisjet €'000	Fabrika me lizing €'000
Kosto/vlërësimi	75,600	140,400	60,000
Minus zhvl. i akm	<u>0</u>	<u>(38,400)</u>	<u>(15,000)</u>
Vlera bartëse në fillim	75,600	102,000	45,000
Zhvlerësimi	<u>(5,400)</u>	<u>(25,500)</u>	<u>(15,000)</u>
Vlera bartëse në fund	70,200	76,500	30,000
Teprica e rivlerësimit	<u>4,500</u>	<u>0</u>	<u>0</u>
Vlerësimi VB	74,700	76,500	30,000

Total PFP (përrjashtuar fabrikën e specializuar) 181,200.

2.

	Kosto e shitjes €'000	K. Administrative €'000	Sh. Shpërndarjes €'000
Sipas bilancit provues	703,500	82,500	58,500
Shpenzimet e zhvl.:			
Prona	5,400		
Fabrika	25,500		
Fabrika me lizing	15,000		
Kontrata (L3)	<u>39,600</u>		
	789,000	<u>82,500</u>	<u>58,500</u>

3. Kontrata e ndërtimit - Të hyrat

Fitimi i përgjithshëm

Çmimi i kontratës	150,000
Kosto deri më datë	(36,000)
Kosot deri në përfundim	(30,000)
Fabrika e specializuar	<u>(24,000)</u>
Total fitimi i vlerësuar	60,000

% përfundimit = Puna e çertifikuar/çmimi i kontratës

€66 milion/150 milion x 100 = 44%

Ekstrat i PA

Të hyrat ((44% x 150 milion)	66.0 milion
Kosto (44% x 90 milion)	<u>(39.6 milion)</u>
Fitimi	26.4 milion
<u>Pasuritë e kontratës</u>	
- Kosto deri me datë	36,000
- Zhvl. i fabrikës së specializuar (L14)	6,000
- Fitimi	<u>26,400</u>
- Minus pagesat nga klienti	<u>(17,100)</u>
	51,300

4. Zhvlerësimi i fabrikës së specializuar = 24,000/2 vite x 6/12

VB = 24,000 - 6,000 = 18,000

5. Detyrimi ndaj lizingut

	Saldo fillim	interesi 8%	pagesat	Saldo fund
Viti deri me <u>31 dhjetor 2019</u>	46,800	3,744	(18,000)	32,544
Viti deri me <u>31 dhjetor 2020</u>	32,544	2,604	(18,000)	17,148

Kosto financiare për vitin aktual = 3,744

Detyrimi afatgjatë = 17,148

Detyrimi afatshkurtë = 15,396

6. Fitimet e mbajtura

Saldo në fillim 132,300

Fitimi i vitit 59,556

Dividenda e paguar (24,000)

Dividenda e deklaruar (400)

167,456

7. Shpenzimet e tatimit

Tatimi aktual

Provizionet në fillim 13,500

Shto nënprovizionimin 2,100

Tek PA 15,600

Tatimi i shtyrë

Provizionet sipas BV (25,200)

Provizionet në fund 16,800

Kredi tek PA (8,400)

Total shpenzimi $15,600 - 8,400 = 7,200$

3.

(a)

Kontabilisti tek Venus sh.a ka marrë pushim mjekësor dhe ka disa çështje të mbetura të cilat duhet të zgjidhen para se të përgatiten pasqyrat financiare. Vitit përfundon me 31 dhjetor 2019 dhe juve ju është kërkuar të përgatitni korigjimet për transaksionet në vijim:

- i) Venus sh.a kishte €300,000 të kostos së huamarrjes gjatë vitit dhe e tërë shuma është njohur si shpenzim në pasqyrën e të ardhurave. Ju tani e keni kuptuar që €50,000 nga kjo shumë ka të bëjë me ndëtimin e një depo të mallrave e cila është një pasuri kualifikuese. **(3 pikë)**
- ii) Gjatë vitit Venus sh.a shiti mallra me garancion. Departamenti i prodhimit ka vlerësuar se kosto e riparimit për mallrat e shitur këtë vit do të jetë €265 000. **(3 pikë)**
- iii) Me 1 janar 2019 Venus sh.a hyri në një transaksion të lizingut financir për një periudhë tre vjeçare. Vlera e drejtë e pasurisë nën lizing ishte €250,000 dhe pagesat e lizingut ishin në shume prej €100,525 me 31 dhjetor të çdo fundviti. Norma e interesit e nënkuptuar në lizing ishte 10%.

Hyrjet e vetme për këtë transaksion ishin:

Debi	Shpenzim/kosto e lizingut	€100,525	
Kredi	Paraja		€100,525

(7 pikë)

- iv) Saldoja aktuale e detyrimit të tatimit të shtyrë është €450,000. Detyrimi i tatimit të shtyrë me 31 dhjetor 2019 është llogaritur të jetë €400,000. **(2 pikë)**

Kërkohet:

Për secilin prej katër transaksioneve më sipër shpjego trajtimin në kontabilitet dhe përgatitni hyrjet në ditar. Për transaksionin iii) nuk ju kërkohet të ndani detyrimin në afatshkurtë dhe afatgjatë.

b)

Pas korigjimeve më lartë, fitimi pas tatimit për vitin 2019 i Venus sh.a-së ishte €740,000. Në fillim të vitit financiar 1 janar 2019 Venus sh.a kishte 6,000,000 aksione të zakonshme me vlerë nominale prej €1. Me 31 mars 2019 emetoi 1,200,000 aksione të zakonshme të reja me një çmim prej €5 euro për aksion, ndërsa me 30 shtator 2019 emetoi edhe 2,000,000 aksione të zakonshme të tjera me çmim prej €10 për aksion.

Kërkohet:

Llogarite FPA-në themelore për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019. (5 pikë)

**Total (20
pikë)**

Zgjidhja e problemit 3

(a)

- i) Kosto e huamarrjes prej €50,000 duhet të kapitalizohet pasi që ka të bëjë me interesin e shkaktuar për një pasuri kualifikuese. SNK 23 *Kostot e huamarrjes* në mënyrë të veçantë thotë që kostot e huamarrjes të cilat janë direkt të atribueshme duhet të kapitalizohen. €50,000 duhet të largohen nga pasqyra e të ardhurave dhe t'i shtohen kostos së depos së mallrave. Hyrja e kërkuar është:

Debi	Pasuritë jo-qarkulluese/depo	€50,000	
Kredi	Shpenzime/kosto e financimit		€50,000

- ii) Së pari duhet përcaktuar nëse ka një detyrim aktual si rezultat i ngjarjeve të kaluara. Shitja e mallrave me garancion nënkupton që të dy këto kritere përmbushen. Pika tjetër është nëse ka gjasa të daljes së përfitimeve ekonomike jashtë kompanisë. Edhe ky kriter është përmbushur pasi që departamenti i prodhimit i ka vlerësuar kostot e riparimit. Atëhere një provizion sipas këtij vlerësimi duhet të njihet. .

Debi	Shpenzimet	€265,000	
Kredi	Provizionet		€265,000

- iii) Lizingu duhet të njohet si një pasuri dhe detyrim pasi Venus sh.a mban rreziqet dhe shpërblimet e pronësisë. Në pasqyrën e të ardhurave një kosto financiare prej 10% të detyrimit duhet të njihet e jo tërë pagesa e lizingut. Pagesa e kryegjësë së lizingut duhet të zbritet nga detyrimi ndaj lizingut. Pasuria duhet të zhvlerësohet përgjatë jetës së përdorimit.

Detyrimi ndaj lizingut

Viti	Fillim	Interesi (10%)	Kryegjësja	Total	Fund
1	250,000	25,000	75,525	100,525	174,475

Zhvlerësimi

$$250,000/3 = 83,333$$

Hyrja tashme e regjistruar duhet të anulohet.

Debi	Paraja	€100,525	
Kredi	Shpenzim/kosto e lizingut	€100,525	

Keto jane hyrjet e duhura

Debi: PJQ	€250,000	
Kredi: Detyrimi ndaj lizingut	€250,000	
Debi: PA – shpenzim i zhvlerësimit	€83,333	
Kredi: Zhvlerësimi i akumuluar	€83,333	
Debi: Detyrimi ndaj lizingut	€100,525	
Kredi: Paraja	€100,525	
Debi: PA – Kosto financiare	€25,000	
Kredi: Detyrimi ndaj lizingut	€25,000	

- iv) Detyrimi i tatimit të shtyrë duhet të zvogëlohet për të siguruar se reflekton detyrimin në fund të vitit.

Debi	Detyrimi i tatimit të shtyrë – PPF	€50,000	
Kredi	Shpenzimet e tatimit - PA		€50,000

(b)

Llogarite numrin mesatar të ponderuar të aksioneve

Nr i akioneve në fillim (6,000,000 x 12/12)	6,000,000
Aksionet e emetuara me 31 mars 2019 (1,200,000 x 9/12)	900,000
Aksionet e emetuara me 31 shtator 2019 (2,000,000 x 3/12)	<u>500,000</u>
	7,400,000

Llogarite FPA-në

$740,000/7,400,000 = \text{€}1$

4.

a)

Ju jeni të punësuar tek Minerva sh.a dhe drejtori financiar ju ka kërkuar këshilla për përgatitjen e pasqyrave financiare për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019. Ai ju ka dhënë informatat në vijim:

- (i) Në stoqet e fundvitit ka mallra të cilat ishin blerë nga Minerva sh.a sipas një marrëveshje të konsignacionit. Kjo marrëveshje i mundeson Minerva sh.a-së të kthej mallrat në çfardo kohe dhe me çmim që do të përcaktohet nga ndryshimet në treg. **(4 pikë)**
- (ii) Bordi i Minerva sh.a-së u takua me 1 dhejtor 2019 dhe mori vendim për të shitur depo të mallrave. Në fund të vitit depo e mallrave është venë në shitje dhe shitja konsiderohet se ka shumë gjasa të ndodhë. **(3 pikë)**
- (iii) Në fillim të janarit 2020 kishte vërshime në një nga depot e Minerva sh.s-së. Vërshimi shkaktoi dëmë tek stoqet të cilat kishin kushtuar €125,000 dhe tani duhet shkatërruar. **(3 pikë)**

Kërkohet:

Për rastet (i) deri (iii), shpjego trajtimin e duhur në kontabilitet dhe impaktin në pasqyrat financiare. Në përgjigjen tuaj ju duhet të i referoheni standardeve dhe koncepteve përkatëse të kontabilitetit.

b) Shpjego dy treguesit më poshtë dhe trego rëndësinë e tyre për investitorët në vlerësimin e performancës financiare:

- i) **Fitimi për aksion** **(2 pikë)**
- ii) **Koeficinti çmim/fitim** **(2 pikë)**

c) Vulcan sh.a bleu një fabrikë për €2,000,000 me 1 janar 2017. Kishte një vlerësim të jetës së përdorimit prej tetë viteve dhe vlerë të mbetur prej €400,000. Fabrika zhvlerësohet në baza drejtvizore. Autoritetet tatimore e aplikojnë lejimin kapital (zhvlerësimin) me normë 40% të koston në vitin e parë dhe 20% në vitet më pas sipas saldosh të zbritur. Norma e tatimit është 30%.

Kërkohet:

Në lidhje me fabrikën më sipër, llogarite ndikimin e tatimit të shtyrë nga rritja apo zvogëlimi i tij në pasqyrën e të ardhurave të Vulcan sh.a-së për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019 dhe saldosh të tatimit të shtyrë në pasqyrën e pozitës financiare në po atë datë. **(6 pikë)**

Zgjidhja e problemit 4

a)

(i) Mallrat në konsignacion duhet të kontabilizohen duke iu referuar substancës së transaksionit, që do të thotë të mirret parasysh substanca tregtare e jo thjesht forma ligjore e transaksionit. Minerva sh.a duhet të marrë parasysh nëse ata i mbajnë rreziqet dhe shpërblimet e këtyre stoqeve. Fakti që Minerva sh.a ka të drejtën t'i kthej mallrat në çfardo kohe si dhe fakti që çmimet mund të ndryshojnë tregton se Minerva sh.a nuk i bartë rreziqet e pronësisë. Stoqet nuk duhet të përfshihen në stoqet e Minerva sh.a-së dhe transaksioni i regjistruar duhet të kthehet mbrapsht.

(ii) Kushtet në vijim duhet të plotësohen për të vendosur nëse depo e mallrave duhet të klasifikohet si pasuri e mbajtur për shitje në pajtim me SNRF 5 *Pasuritë jo-qarkulluese të mbajtura për shitje dhe operacionet e ndërprera*. Kushtet janë që menaxhmenti të jetë i zotuar ndaj një plani dhe depo e mallrave të jetë në dispozicion për shitje të menjëhershme. Ata janë në mënyrë aktive duke kërkuar një blerës dhe shitja duhet të këtë gjasa të mëdha të ndodh pa ndryshime të pritura. Bazuar në faktet në detyrë duket se depo e mallrave i plotëson këto kushte dhe duhet larguar nga pasuritë jo-qarkulluese dhe të vendoset tek pasuritë jo-qarkulluese të mbajtura për shitje.

Depo e mallrave duhet të matet sipas më të ulëtës ndërmjet vlerës bartëse dhe vlerës së drejtë minus kostos për ta shitur. Zhvlerësimi duhet të ndërpritet.

(iii) Vërsimi është një ngjarje pas periudhës raportuese dhe vendimi është nëse është një ngjarje korigjuese apo jo-korigjuese. Vërsimi është një shembull i ngjarjes jo-korigjuese pasi që kushtet nuk kanë ekzistuar në fund të vitit. Nëse shuma është materiale duhet të shpaloset në pasqyrat financiare.

b)

(a)

i. Fitimi për aksion – Fitimet të cilat janë në dispozicion të mbajtësve të ekuitetit. Fitimi për aksion është një matës i shumës së fitimeve gjatë një periudhë financiare për çdo aksion të ekuitetit.

FPA = Neto fitimi i atribuar aksionarëve të zakonshëm/numrin mesatar të ponderuar të aksioneve gjatë periudhës

Rendësia

- FPA përdoret nga investitorët si një matje e performancës së kompanive në të cilën ata kanë ose dëshirojnë të investojnë.
- Tregon për shëndëtin financiar të një kompanie.
- Ndihmon në zgjedhjen gjatë blerjes së aksioneve.
- Është një input në koeficientin çmim/fitim.
- Jep një pasqyrë më të saktë të fitimeve aktuale sa sa fitimi i raportuar.
- FPA mund të ketë ndikim të madh në çmimet e aksioneve të kompanisë.
- FPA shërben si mënyrë të vlerësimit të menaxhmentit të kompanisë

ii. Koeficienti çmim/fitim (Ç/F)

- Koeficienti çmim/fitim është një matës i çmimit aktual të aksioneve në raport me FPA-në.

Koeficienti Ç/F = Çmimi i tregut për aksion / FPA

Rendësia

- Mund të përdoret nga investitorët për të përcaktuar nëse çmimi i aksionit është shumë i shtrejtë apo shumë i lirë.
- Është një tregues i performancës që pritet në të ardhmen nga kompania.
- Një koeficient i lartë Ç/F u jep investitorëve besim në aksionet e kompanisë, pasi që ata janë të gatshëm të paguajnë çmim më të lartë për aksionet.
- Një koeficient i lartë Ç/F është një tregues i qeverisjes së fortë korporative të një kompanie.
- Tregon aftësinë e kompanisë për të paguar dividend të larta dhe stabile.

c) Vlera bartëse me 31 dhjetor 2019

	€'000	€'000
Kosto e fabrikës		2,000
Zhvlerësimi i akumuluar me 31 dhjetor 2019 (2,000-400)/8 vite për 3 vite (200 x 3)		<u>(600)</u>
Shuma bartëse		1,400
<u>Baza tatimore me 31 dhjetor</u>		
Baza tatimore në fillim (kosto origjinale)	2,000	
Viti deri me 31 dhjetor 2017 (2,000 x 40%)	800	
Viti deri me 31 dhjetor 2018 (1,200 x 20%)	240	
Viti deri me 31 dhjetor 2019 (960 x 20%)	192	<u>(1,232)</u>
Baza tatimore me 31 dhjetor 2019		768
Diferenca e përkohshme me 31 dhjetor 2019 (1,400 -768)		632
Detyrimi tatimit të shtyrë me 31 dhjetor 2019 (632 x 30%)		189.6
Kredi në PA për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019 (192(L1) -189.6)		2.4

Llogaritjet:

Detyrimi tatimit të shtyrë me 31 dhjetor 2018	€'000	
Vlera bartëse 2018		
Kosto e fabrikës	2,000	
Zhvlerësimi i akumuluar deri me 2018	<u>(400)</u>	
Vlera bartëse 2018	1,600	
 Baza tatimore - 2018		
Kostoja fillestare e fabrikës	2,000	
Zhvl: viti 2017 (2,000 x 40%)	(800)	
Viti 2018 (1,200 x 20%)	<u>(240)</u>	
	960	
Diferenca e përkohshme - 2018 (1600 - 960) =	640	
Detyrimi tatimit të shtyrë me 31 dhjetor 2018 (640 x 30%)	192	

5.

Ju jeni këshilltar financiar. Menaxhmenti i Mars sh.a-së, një kompani shumë e diversifikuar më njësi në të gjithë Kosovën ka disa transaksione për të cilat kërkon këshillë nga ju. Mars sh.a ka një kontabilist financiar i cili ende nuk është i kualifikuar si i tillë. Transaksionet janë si në vijim:

(a) Kompania ka identifikuar një njësi gjeneruese të parasë gjatë vitit të përfunduar me 31 dhjetor 2019 e cila përbëhet nga pasuritë e mëposhtme.

Kostot	€'milion
Prona, fabrika dhe paisjet	4,050
Zëri i mirë	450
Pasuritë tjera	<u>2,700</u>
	7,200

Menaxhmenti i management of Mars sh.a-së vlerësoi se shumica e rikthyeshme e njësisë gjeneruese të parasë në fund të vitit do të jetë €6.3 miliardë. Kontabilisti financiar i Mars sh.a-së ka pak njohuri për kërkesat e SNK 36 *Dëmtimi i pasurive* por është i hutuar se si dëmtimi i këtyrë pasurive nëse ka ndonjë, duhet të alokohet tek këto pasuri të cilat përbëjnë njësinë gjeneruese të parasë së kompanisë. **(7 pikë)**

(b) Gjithashtu me 1 janar 2019 Mars sh.a huazoi €300 milion për të financuar ndërtimin e dy pasurive të cilave u duheshin një vit për tu përfunduar.

Puna filloi me 1 janar 2019. Kredia ishte marrë në po të njejtën ditë dhe ishte shfrytëzuar si në vijim, përderisa teprica e fondeve ishte investuar përkohësisht.

	Pasuria X	Pasuria Y
	€'000	€'000
1 janar 2019	50,000	100,000
1 korrik 2019	50,000	100,000

Norma e interest në kredi ishte 9% në vit dhe Mars sh.a mund të investoj tepricen e fondeve me 7% në vit. Kontabilisti financiar nuk është i sigurtë se si duhet të kontabilizohen këto pasuri në pasqyrat financiare të Mars sh.a-së me 31 dhjetor 2019. **(7 pikë)**

(c) Mars sh.a ka në pronësi një ndërtesë të cilën e ka përdorur si zyre qendrore në Prishtinë. Me qëllim të zvogëlimit të kostove menaxhmenti i kompanisë me 30 qershor 2019 vendosi të zhvendosë zyrën e saj qendrore në Dragash dhe tani e ka lëshuar me qira ndërtesën në Prishtinë.

Është politikë e kontabilitetit të kompanisë që të përdor modelin e vlerës së drejtë për Pronën Investuese. Ndërtesa e zyrës së mëhershme qendrore në Prishtinë kishte një kosto fillestare prej €37.5 milion me 1 janar 2010 dhe ishte duke u zhvlerësuar për 50 vite dhe nuk ishte dëmtuar gjatë kësaj kohe. Me 30 qershor 2019 vlera e drejtë e kësaj ndërtese ishte vlerësuar nga një vlerësues i pavarur në €52.5 milion dhe kjo vlerë kishte mbetur e njejtë deri në datën e raportimit me 31 dhjetor 2019. Kontabilisti financiar nuk është i sigurtë se si duhet të trajtohet kjo ngjarje në pasqyrat financiare të kompanisë. Injoro të hyrat nga qiraja pasi që nuk janë dhënë informata.

(6 pikë)

Kërkohe:

Shkruani një memo menaxhmenti të Mars sh.a- së për të shpjeguar se si transaksionet e mësipërme duhet të kontabilizohen në pasqyrat e tyre financiare. Tregoni llogaritjet aty ku është e nevojshme.

(Total 20 pikë)

Zgjidhja e problemit 5

Nga: Filan Fisteku (Këshilltar për Raportim Financiar)

Për: Menaxhmentin e Mars sh.a

Data: 18 janar 2020

Tema: Shpjegim i trajtimit në kontabilitet të disa transaksionve

Ju lutem lexoni më poshtë detajet e shpjegimit të tri çështjeve të ngritura nga ju lidhur me trajtimin e tyre në kontabilitet. Çështjet kërkojnë aplikimin e disa prej Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të cilat i kam shpjeguar më poshtë.

(a) Humbjet nga dëmtimi duhet të alokohen tek pasuritë e njësisë gjeneruese të parasë siapas SNK 36 *Dëmtimi i pasurive*.

- Kontabilisti financiar duhet të përcaktoj shumën totale të humbjeve nga dëmtimi e cila është (€7.2 miliardë minus €6.3 miliardë) pra €900 milion.
- Nga kjo humbje €450 milion duhet të alokohet tek zëri i mirë për të zvogëluar deri në shumën zero.
- Pjesa e mbetur prej €450 milion duhet të alokohet tek prona, fabrika dhe paisjet dhe pasuritë tjera si në vijim:
 - i) Prona Fabrika dhe Paisjet $€450m \times 4,050m / 6,750m = €270m$
 - ii) Pasuritë Tjera $€450m \times 2,700m / 6.750m = \underline{€180m}$
€450m

Vlerat bartëse të pasurive që duhet të tregohet në pasqyrat financiare të Mars sh.a-së me 31 dhjetor 2019 janë si në vijim:

	Kosto	Dëmtimi	Vlera bartëse
	€'m	€'m	€'m
Prona, fabrika dhe paisjet	4,050	(270)	3,780
Zëri i mirë	450	(450)	-
Pasuritë tjera	<u>2,700</u>	<u>(180)</u>	<u>2,520</u>
	7,200	900	6,300

(b) Në një situatë ku kompania Mars sh.a huazon për të financuar ndërtimin e pasurive SNK 23 *Kostot e huamarrjes* thekson që kostot e huamarrjes direkt të atribueshme për blerjen, ndërtimin apo prodhimin e pasurive të kualifikueshme duhet të identifikohen dhe kapitalizohen. Kosto e huamarrjes e cila duhet të kapitalizohen si kosto e pasurive X dhe Y me 31 dhjetor 2019 është si në vijim:

	Pasuria X	Pasuria Y
	€'000	€'000
Kosto e huamarrjes	9,000	18,000
X = (€100m x 9%); Y = (€200 x 9%)		
Minus: të ardhurat nga investimi		
X = (€50m x 7% x 6/12); Y = (€100m x 7% x 6/12)	<u>(1,750)</u>	<u>(3,500)</u>
Neto kosto e huamarrjes	7,250	14,500

Andaj, kosto e pasurive X dhe Y të Mars sh.a-së që duhet të tregohet në pasqyrën e pozitës financiare të Mars sh.a-së me 31 dhjetor është:

	Pasuria X	Pasuria Y
	€'000	€'000
Kosto e pasurive	100,000	200,000
Kosto e huamarrjes e kapitalizuar	<u>7,250</u>	<u>14,500</u>
	107,250	214,500

(c) Ri klasifikimi i pronës së zënë nga pronari në pronë investuese (sipas modelit të vlerës së drejtë) në pajtim me SNK 40 Prona investuese kërkon që të bëhen veprimet si në vijim atëherë kur ka ndryshim në përdorim:

i) Përcaktimi i vlerës së drejtë në datën e ndryshimit të përdorimit.

ii) Diferenca ndërmjet vlerës së përcaktuar në i) dhe vlerës bartëse duhet të kontabilizohet sipas SNK 16. Kjo nënkupton që një përfitim duhet të njihet të të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse dhe të përfshihet në ekuitet në tepricën e rivlerësimit por në rast të një humbje ajo duhet të njihet në pasqyrën e të ardhurave.

iii) Nga data e riklasifikimit, prona nuk zhvlerësohet më.

iv) Në çdo datë të raportimit, vlera e drejtë e pronës duhet të ri-matet.

Ndërtesa në fillim ishte pasuri jo-qarkulluese sipas SNK 16: Prona , fabrika dhe paisjet deri me 30 qershor 2019 kur pati një ndryshim në përdorim dhe nga kjo datë aplikohet SNK 40 Prona investuese. Kontabilizimi është si në vijim:

	€'m	€'m
<u>Vlera e drejtë me 31 dhjetor 2019</u>		52.5
Minus:		
<u>Vlera bartëse me 30 qershor 2019</u>		
Kosto në fillim	37.5	
Zhvlerësimi 1 janar 2010 deri 30 qershor 2019 (37.50/50 vite x 10.5 vite)	(7.875)	<u>29.625</u>
Përfitim i vlerës së drejtë në pronën investuese		22.875
<u>Ekstrakt i pasqyrës së të ardhurave dhe të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse</u>		
	€'m	
Zhvlerësimi	(0.375)	
Përfitim i vlerës së drejtë në pronën investuese	22.875	
<u>Ekstrakt i pasqyrës së pozitës financiare</u>		
Pasuri themelore	€'m	
Prona investuese	52.5	